



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA RAJONALE E EKSTENSIONIT BUJQËSOR SHKODËR

RAPORT MONITORIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT

Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Shkodër

2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE

METODOLOGJIA E MONITORIMIT

PROGRESI NË ZBATIM DHE GJETJET E RAPORTIT

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

1. Hyrje

Ky raport monitorimi paraqet vlerësimin e nivelit të zbatimit të Planit të Integritetit të Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Shkodër (AREB Shkodër) për vitin 2025.

Plani i Integritetit është hartuar në përputhje me objektivat e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe synon forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe integritetit institucional në ofrimin e shërbimeve publike për fermerët dhe sektorin bujqësor.

Integriteti institucional përfshin respektimin e parimeve të etikës, ndershmërisë, transparencës, efektivitetit dhe eficiencës në ushtrimin e funksioneve administrative dhe rregullatore të institucionit.

Ky raport analizon progresin e arritur gjatë vitit 2025, sfidat e hasura dhe masat e ndërmarra për përmirësimin e mëtejshëm të funksionimit të institucionit.

2. Metodologjia e Monitorimit

Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit është realizuar nëpërmjet:

- Analizës së dokumentacionit institucional;
- Intervistave dhe konsultimeve me stafin e institucionit;
- Vlerësimit të zbatimit të masave të parashikuara në planin e veprimit;
- Analizës së risqeve të integritetit në sektorët kryesorë të institucionit.

Drejtori dhe strukturat përgjegjëse kanë kryer monitorime periodike gjatë vitit 2025 për të analizuar progresin dhe për të identifikuar sfidat në zbatimin e planit.

- GRUPI I PUNËS PËR HARTIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT

Emri	Pozicioni
Pjerin Spathari	Drejtore
Marie Lumçi	Përgjegjës i Financës dhe Shërbimeve
Sherif Brahaj	Përgjegjës Sektori i Specialistëve të Profilizuar
Kujtim Rrukaj	Specialist Hortikulture



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3. Progresi në Zbatimin e Planit të Integritetit

- OBJEKTIVAT STRATEGJIKË 2023-2025

3.1. Rritja e Efektivitetit në Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Gjendja aktuale:

Struktura e institucionit ka 58 punonjës, nga të cilët 7 pozicione janë ende vakante. Në përputhje me legjislacionin janë bërë azhurnimet me udhëzimet dhe ndryshimet ligjore në funksion të aktivitetit të arkivës, protokollit dhe burimeve njerëzore. Stafit është informuar vazhdimisht mbi rregulloret për konfliktin e interesit dhe integritetin në shërbimin publik.

Përmirësime:

- Përmirësim në procedurat e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Rritje e ndërgjegjësimit të stafit për integritetin dhe etikën në punë.

Sfida:

- Plotësimi i vendeve vakante;
- Rritja e kapaciteteve profesionale të stafit përmes trajnimeve.

Masat dhe Aktivitetet		Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të parealizuara
Masa/ Aktivitete		4	3	1	0



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3.2. Sigurimi i Informacionit Bashkëkohor për Bujqësinë

Gjendja aktuale:

AREB Shkodër gjatë vitit 2025 ka vijuar aktivitetet e këshillimit dhe asistencës për fermerët, përmes: organizimit të trajnimeve në terren, asistencës për krijimin e SHBB-ve, monitorimit të çmimeve në tregjet e shumicës, raportimit në Portalin e Fermerit dhe realizimit të Vrojtimeve Bujqësore dhe anketave për agroindustrinë.

Përmirësime:

- Rritje e aktiviteve informuese dhe këshilluese për fermerët;
- Përmirësim i raportimit të të dhënave bujqësore.

Sfida:

- Mungesa e mjeteve të transportit për specialistët në terren;
- Shtrirja më e madhe e shërbimeve në zonat rurale.

Realizimi i Masave dhe Aktiviteve				
Masat dhe Aktivitetet	Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të parealizuar
Masa/ Aktivitete	6	4	2	0

3.3. Menaxhimi i Dokumentacionit dhe Arkivimi

Gjendja aktuale:

Dokumentacioni në institucion administrohet në përputhje me rregullat për protokollimin dhe arkivimin e dokumenteve.

Përmirësime:

- Zbatim më i mirë i procedurave të administrimit të dokumentacionit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Sfida:

- Nevoja për digjitalizimin gradual të arkivës për të rritur efikasitetin dhe sigurinë e informacionit.

3.4. Menaxhimi Financiar

Gjendja aktuale:

Proceset financiare gjatë vitit 2025 janë realizuar në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret përkatëse. Nuk janë evidentuar parregullsi në administrimin e fondeve dhe në dokumentacionin financiar.

Përmirësime:

- Respektimi i afateve të raportimit financiar dhe përputhja e tyre me kuadrin ligjor.
- Përmirësim i kontrollit të brendshëm financiar.

Sfida:

- Rritja e transparencës në publikimin e informacionit financiar për publikun publik.

- RISQET E INTEGRITETIT DHE VLERËSIMI I TYRE

Nr.	Fusha	Përshkrimi i Situatës	Risku i Integritetit
1	Menaxhimi financiar	Planifikimi vjetor dhe afatmesëm i fondeve buxhetore. Zbatimi i buxhetit, sipas zërave buxhetorë dhe të ardhurave dytësore.	Risk i mesëm
2	Menaxhimi i burimeve njerëzore	Forcimi i kapaciteteve njerëzore përmes plotësimit në kohë të vendeve vakante, procesit të rekrutimit dhe zhvillimit profesional të stafit.	Risk i mesëm
3	Arkivimi dhe administrimi i dokumenteve	Dokumentacioni është i unifikuar, me protokoll dhe arkivim sipas rregullave.	Pa risk



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

4	Ofrimi i informacionit për bujqësinë	Sigurimi i të dhënave statistikore, analizave ekonomike dhe parashikimeve të besueshme për sektorin bujqësor, blegtoral dhe agroindutrial. Nevojitet më shumë mbështetje logjistike për specialistët e ekstensionit.	Risk i mesëm
---	--------------------------------------	--	--------------

- MASAT PËR MENAXHIMIN E RISQEVE TË INTEGRITETIT

Nr.	Masa e Marrë	Afati	Përgjegjësi
1	Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore përmes plotësimit në kohë të vendeve vakante, zhvillimit profesional dhe trajnimeve të vazhdueshme të stafit.	2023-2025	Burime Njerezore AREB Shkodër
2	Plotësimi dhe përditësimi i dokumentacionit të personelit, si dhe rritja e eficiencës në realizimin e detyrave funksionale dhe objektivave institucionale.	2023-2025	Burime Njerezore AREB Shkodër
3	Hartimi dhe zbatimi i rregullave për administrimin, arkivimin dhe inventarizimin e dokumentacionit, në përputhje me kuadrin ligjor dhe normat tekniko-profesionale në fuqi.	2023-2025	Burime Njerezore AREB Shkodër
4	Sistematizimi, ruajtja dhe përpunimi i dokumentacionit arkivor dhe financiar ndër vite, duke siguruar vazhdimësinë dhe përputhshmërinë me kërkesat institucionale.	2025	Burime Njerezore AREB Shkodër
5	Zgjerimi i përfshirjes së fermave në studime, kërkime dhe aktivitete zhvillimore.	2025	Drejtori i AREB Shkodër
6	Forcimi i bashkëpunimit me fermerët dhe ofrimi i asistencës teknike të specializuar.	2025	Drejtori i AREB Shkodër



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

7	Organizimi dhe zhvillimi i trajnimeve në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë. Zbatimi në praktikë i rezultateve të projekteve dhe përmirësimi i prodhimit bujqësor..	2025	Drejtori i AREB Shkodër
8	Intensifikimi i bashkëpunimit institucional me MBZHR, bashkitë dhe strukturat përkatëse.	2025	Drejtori i AREB Shkodër
9	Përditësimi i njohurive me teknologji bashkëkohore dhe përshtatja me kushtet klimatike vendase.	2025	Drejtori i AREB Shkodër
10	Përmirësimi i infrastrukturës për specialistët në terren.	2025	Drejtori i AREB Shkodër

- MONITORIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT

Aktiviteti	Frekuenca	Përgjegjësi
Mbledhja e të dhënave për zbatimin e planit	Çdo 6 muaj	Drejtori i AREB Shkodër
Raportimi i progresit	Vjetor	Drejtori i AREB Shkodër
Publikimi i rezultateve	Vjetor	Institucioni dhe MBZHR

4. Përfundime dhe Rekomandime

4.1. Përfundime

Nga monitorimi i kryer rezulton se AREB Shkodër gjatë vitit 2025 ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit dhe ka realizuar një pjesë të konsiderueshme të masave të parashikuara.

Institucioni ka bërë përparime në:

- forcimin e kapaciteteve të stafit;
- rritjen e transparencës;
- përmirësimin e monitorimit të brendshëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Megjithatë, disa sfida mbeten në fushën e burimeve njerëzore dhe në përmirësimin e infrastrukturës për shërbimet në terren.

4.2. Rekomandime

- *Plotësimi i vendeve vakante në strukturën e institucionit*

Të përshpejtohen procedurat e rekrutimit për të siguruar funksionim efikas dhe përmirësim të cilësisë së shërbimeve

- *Digjitalizimi i dokumentacionit dhe arkivës*

Të implementohen sisteme elektronike për menaxhimin e dokumenteve, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe sigurisë së të dhënave.

- *Shtimi i mjeteve të transportit për specialistët e ekstensionit*

Të sigurohen mjete shtesë për specialistët e ekstensionit, për të përmirësuar mbulimin dhe shërbimin në terren.

- *Rritja e transparencës në publikimin e aktiviteteve dhe raporteve institucionale*

Të rritet publikimi i rregullt i aktiviteteve dhe raporteve në kanalet zyrtare për forcimin e llogaridhënies dhe besimit publik.

5. Përfundim

Zbatimi i Planit të Integritetit në AREB Shkodër gjatë vitit 2025 ka pasur një ecuri pozitive. Megjithëse janë arritur rezultate të rëndësishme në disa fusha, nevojiten përmirësime të mëtejshme për të forcuar integritetin institucional dhe për të rritur cilësinë e shërbimeve për sektorin bujqësor.

Data: 19.03.2026

DREJTOR: PJerin SPATHARI

